



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 530/7 Prot.

Tiranë, më 09.12.2016

V E N D I M

Nr. 153, datë 09.12.2016

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 530/1 prot, datë 06.09.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe DAP, për rastin e nëpunësit *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 530/1 prot, datë 06.09.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ përfunduar, me aktin nr. 6011/2, dt. 14.09.2016, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme “Për lirimin nga shërbimi civil të *****” për arsye të dy vlerësimeve negative, të njëpasnjëshme.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, me shkresën nr. 530/3, datë 06.09.2016 dhe shkresën nr. 530/4, datë 06.09.2016, u vunë në dijeni Ministria e Punëve të Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike, për fillimin e këtij verifikimi, si dhe u kërkua nga institucionet, dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e tij.

Nëpërmjet përgjigjeve të ardhura nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht me shkresat nr. 5403/1, datë 26.09.2016 dhe nr. 5322/7, datë 15.09.2016, Komisionerit i është vënë në dispozicion gjithë materiali i praktikës shkresore në lidhje me shkaqet dhe zhvillimin e kësaj ecurie disiplinore. Ndërkaq, gjatë zhvillimit të hetimit administrativ është konstatuar se kjo mosmarrëveshje, është regjistruar si çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me nr. 6323, dt. 09.11.2016, me palë *****

kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, me objekt: *“Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 6011/2 datë 14.09.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm për lirim nga shërbimi civil; kthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës si Drejtor Operacional të Drejtimit Komandimit të Emergjencave Civile në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë”*.

Në këto kushte, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, ku përcaktohet se, institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësohet se në këtë rast, nuk është e nevojshme ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 90 të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 530/1 prot., datë 06.09.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Për verifikimin e ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 6011/2 dt. 14.09.2016, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme”* për lirimin nga shërbimi civil të *****, për arsye të dy vlerësimeve negative, të njëpasnjëshme.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe kërkuesi, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA